UDHËZIM
Nr. 25, datë 10.11.2025

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 4.3.2020, TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR AFATET E APLIKIMIT, TË ZBATIMIT TË KRITEREVE DHE PROCEDURAVE, PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT, SI DHE NUMRIN E ANËTARËVE DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR ANËTARË KOMISIONI PËR DHËNIEN E BURSAVE TË PARASHIKUARA NGA FONDI I EKSELENCËS PËR STUDENTËT E SHKËLQYER DHE NËPUNËSIT CIVILË"

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë" (Fondi i Ekselencës), i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 6, datë 4.3.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kritereve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë", bëhet shtesa, si më poshtë:

a) Pas pikës 1, të kreut VI, shtohet pika 1/1 me përmbajtje, si më poshtë:

"1/1. *Përcaktimet e këtij udhëzimi zbatohen vetëm për studentët përfitues të mbështetjes financiare, që vijojnë studimet në vitet e ndërmjetme dhe kanë përfituar bursë nga Fondi i Ekselencës sipas përcaktimeve të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020 të Këshillit të Ministrave, "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)", i ndryshuar.".*

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Komisioni Përzgjedhës dhe Sekretariati Teknik i Programit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi